POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Vlorë/ Luan Muça i 'Deltës' gjobë 5 mln € Bedinajt të 'Regina': Mi jep, ose zhduku për 48 orë! I mësyn në hotel me grup të armatosur, vihet në pranga bashkë me 4 të tjerë! Digjet një 'Audi A8' (VIDEO)
2 Celular në burgun e Fierit, 'e pësojnë' dy të paraburgosur! Pezullohen nga detyra 4 punonjës, u caktohet masa 'detyrim paraqitje'
3 Zbarkuan të armatosur në hotelin e Bedinajt, SWAT Security 'e besuara' e Luan Muçës për sigurinë e çdo biznesi të tij
4 Pas homazheve për Mlladiç, eurodeputeti austriak kërkon pezullimin e negociatave të anëtarësimit me Serbinë: Të ndalen edhe fondet e BE-së
5 'Kam harruar kodin e kasafortës'/ Mashtroi Kejvina Khellën duke i marrë 8 mijë euro, merret e pandehur shoqja e saj kryeinspektore, Anela Osmani

Kronikë

# I vihet tritol lokalit në Durrës! Pronari i dënuar për vrasjen e një klienti! Lëndë plasëse edhe një garazhi (VIDEO)

*Dy shpërthime me lëndë plasëse janë regjistruar brenda një harku të shkurtër kohor në Durrës. Shpërthimi i parë është regjistruar në ambientet e jashtme të një lokali në pronësi të Gëzim Kajno.*

'Plas' tritoli në Durrës! Shpërthim në lokalin e pronarit të dënuar, lëndë
Report TV
Watch on

Redaksia
3 Shtator, 08:38 | **Përditesimi: 3 Shtator, 09:13**

Dy shpërthime me lëndë plasëse janë regjistruar brenda një harku të shkurtër kohor në Durrës. Shpërthimi i parë është regjistruar në ambientet e jashtme të një lokali rreth orës 03:50, në lagjen nr. 11. Sipas informacioneve lokali është në pronësi të 41-vjeçarit Gëzim Kajno, i dënuar me 10 vjet burgim, për veprat penale "Vrasja me dashje" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Në mars të vitit 2016, 41-vjeçari ***vrau*** 29-vjeçarin Asllan Kërtusha. Sipas hetimeve në atë vit viktima ishte i ulur në lokal dhe në gjendje të dehur fyente klientët dhe pronari i lokalit, Gëzim Kajno i kërkoi Kërtushës që të mos i fyente klientët. Pas konfliktit në lokal, sherri u spostua jashtë. Kërtusha tentoi të largohej me taksi, por u nxor me dhunë nga makina nga Gëzimi dhe xhaxhai i tij Bledar Kajno, i cili e qëlloi me plumb në zemër.

Ndërkohë shpërthimi i dytë është regjistruar në derën e garazhit të një automjeti në zonën e Shkallnurit, rreth orës 04:30. Si pasojë e shpërthimit nuk ka të lënduar vetëm dëme materiale.


LEXO EDHE:
**Sherr mes dy shoferësh furgonash në Kavajë, njëri goditet me levë në kokë (VIDEO)**

> *"Rreth orës 03:50, në lagjen nr. 11, Durrës, në derën e jashtme të një lokali në pronësi të shtetasit G. K., është hedhur një sasi e vogël lënde plasëse. Si pasojë, janë shkaktuar vetëm dëme të lehta materiale.*
>
> *Gjithashtu, rreth orës 04:30, në zonën e Shkallnurit, në anë të rrugës Plepa–Ndroq, është hedhur një sasi lënde plasëse në derën e garazhit të një automjeti, duke shkaktuar vetëm dëme materiale", njoftoi sot policia.*

Grupet hetimore, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijojnë veprimet për mbledhjen dhe administrimin e provave, zbardhjen e plotë të rrethanave, si dhe identifikimin dhe kapjen e autorit/autorëve.

Xh.K/E.H/Shqiptarja.com

TAG: tritol Durres gezim kajno

Sa e vlerësoni këtë artikull? 5.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

## Komente

Komento

Emigranti: 03/09/2026 12:53
Nuk ka krime fare eee ...

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 2 Shtator, 23:22
**Qeveria bllokon pagat e magjistratëve pasi KLGJ e KLP i rritën vetë, si e vlerësoni?**
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kontroll në burgun e Durrësit, gjenden 6 celularë
3 Shtator, 09:23

Ekskluzive/ Larg kampit të ferrit në Siri, Abdullahu rinis fëmijërinë në Rrogozhinë! I afërmi: S'dëshiron të flasë për të shkuarën! Shpresë për rikthimin e motrës
Artur Korriku
2 Shtator, 16:19

Policia Bashkiake aksion në Durrës, liron parkimet e zëna forcërisht në rrugë dhe lagje të ndryshme të qytetit
2 Shtator, 16:07

'Bezi' përplaset me Land Rover' në Fushë-Krujë, ndërron jetë gazetari 26-vjeçar! (EMRI+VIDEO)
2 Shtator, 09:56

Projekti TID/ Banorët e Durrësit kërkojnë pezullimin e punimeve: Shtëpinë s'e lëshon njeri (VIDEO)
1 Shtator, 17:04

Aksidenti i mori jetën, 49-vjeçari në Kavajë ishte djali i ish-trajnerit të njohur dhe ish-kryebashkiakes së Shijakut
1 Shtator, 16:31

Dronë, radarë dhe makina inteligjente në rrugët e Durrësit, 8 shoferë në pranga dhe mbi 1.600 gjoba në një javë (VIDEO)
1 Shtator, 14:18

U dhunua nga djemtë e pronarit të hotelit 'Flar' pasi i kërkoi pagën, zbardhet dëshmia e kamerierit: Më goditën me grusht dhe tavëll qelqi në kokë
1 Shtator, 13:43

Autorë të 8-të vjedhjeve në Durrës, arrestohet 49-vjeçari! Në kërkim bashkëpunëtori (EMRI)
1 Shtator, 12:34

VIDEO/ Grushte pa pushim, momenti kur dhunohet kamerieri nga pronarët e hotelit në Golem! I riu: Kërkova pagën, më kërcënuan se do të më vrisnin
1 Shtator, 10:45

Punimet në mbikalimin e Kasharit, ARRSH njoftim për qytetarët: Bllokim i përkohshëm i aksit Tiranë-Durrës dhe anasjelltas për 3 netë
31 Gusht, 18:21

Dhunuan kamerierin 18-vjeçar pasi kërkoi pagën, Gjykata e Durrësit lë në burg djalin e pronarit të hotelit dhe shokun e tij! Në qeli edhe xhaxhai i të riut (VIDEO)
31 Gusht, 11:44

Lajmi i fundit
Celular në burgun e Fierit, 'e pësojnë' dy të paraburgosur! Pezullohen nga detyra 4 punonjës, u caktohet masa 'detyrim paraqitje'
3 Shtator, 21:03

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



**Celular në burgun e Fierit, 'e pësojnë' dy të paraburgosur! Pezullohen nga detyra 4 punonjës, u caktohet masa 'detyrim paraqitje'**

3 Shtator, 21:03